

Qasja në banim dhe shërbime publike
për komunitetet e riadhesuara
në Fushë Kosovë / Kosovo Polje



BEST PRACTICES
for
ROMA INTEGRATION
in the Western Balkans

Autor: Adrian Zeqiri
Hulumtues: Muhamet Arifi



Funded by the EU

Impresum

Maj 2013

Autor:

Adrian Zeqiri

Hulumtues:

Muhamet Arifi

Designo:

comma | communications design

Ky publikim është bërë nga autori me mbështetjen e projektit Praktikrat më të Mira për Integrimin e Romëve (PMIR). Publikimi është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit PMIR, zbatuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian, as politikat dhe pozicionin e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Qasja në banim dhe shërbime publike për komunitetet e riatdhesuara në Fushë Kosovë/ Kosovo Polje

Autor: Adrian Zeqiri
Hulumtues: Muhamet Arifi



Adrian Zeqiri është drejtor ekzekutiv i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë. Në ECMI filloi punën në vitin 2002 ku është marrur me zhvillimin dhe përfshirjen e minoriteteve në procesin e bisedimeve mbi statusin e Kosovës. Para se t'i bashkohej ECMI Kosova, Adriani ka punuar me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Adrian ka përfunduar programin master në administrim biznesi në Universitetin e Sheffield dhe u diplomua në gjuhën angleze në Universitetin e Prishtinës.

Nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat lokale të shoqërisë civile, romë, ashkali dhe egjiptiane, Adrian është njohtuar detalisht mbi statusin dhe nevojat e këtyre komuniteteve. Duke punuar me këto komunitete, veçanërisht në Strategjinë Kombëtare për Integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (e cila u përball me sfida serioze në zbatimin), ai e pa nevojën për të vlerësuar zbatimin e politikave për strehim dhe shërbimet publike për personat e riadhesuar të komuniteteve egjiptianë, romë dhe ashkali. Ai e konsideronte të nevojshme për të kryer një studim për të kuptuar më mirë shkallën e integrimit të personave të riadhesuar të këtyre komuniteteve dhe nevojat e tyre.



Muhamet Arifi është një nga themeluesit dhe njëkohësisht është Drejtor Ekzekutiv i OJQ-se Ballkan Sunflowers Kosova (BSFK). Qysh kur nisi të punoj me BSFK në vitin 2005, Muhameti ndihmoi në zbatimin e mbi 100 projekteve, shumica e të cilëve ishin në dobi të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptianë. Duke qenë vet Ashkali, Muhameti ka përjetuar edhe vet nëpërmjet eksperiencës së drejtë-për-drejtë problemet me të cilat përballen këto komunitete. Muhameti kërkon në mënyrë të vazhdueshme t'i adresojë këto problematika nëpërmjet projekteve, advokimit në nivel qendror dhe lokal, dhe nëpërmejt mekanizmeve të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

Qysh prej viti 2009, deri në vitin 2012, Muhameti ka përfaqësuar komunitetin Ashkali në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK), një mekanizëm ky nën udhëheqjen e Presidentit të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, Muhameti ka drejtuar grupin e punës për çështjet e Romëve, Ashkalijëve dhe Egjiptianëve, si dhe ka qenë anëtar i Grupit Teknik Punues për zbatimin e Strategjisë. Muhameti gjithashtu është angazhuar aktivisht si ekspert në përgatitjen e *Strategjisë për Integrimin e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptianë*.



Fushë Kosovë

Studimi është kryer në komunën e Fushë Kosovës, e cila kufizohet me Prishtinën, kryeqyteti i Kosovës, shtrihet në Kosovën qendrore, dhe është e vendosur në jugperëndim të Prishtinës. Fushe Kosova ka 11% të romëve, ashkalijve dhe egjiptianve (përafërsisht 1% (436) e romëve, 9% (3,230) ashkali dhe 1% (282) egjiptian). Me regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë 2011th është vlerësuar se në Fushë Kosovë, ka gjithsej 34,827 banorë. Fushe Kosova është komuna e parë në Kosovë, e cila e ka miratuar Planin e Veprimit Komunal për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, që ishte si rezultat i përpjekjeve të shoqërisë civile lokale.

Permbajtja

Përmbledhje ekzekutive | 9

1. Hyrje | 11

1.1. Objektivat e hulumtimit 12

Metodologjia | 13

2.1. Hulumtimi preliminar dhe grumbullimi i të dhënave 13

2.2. Mostër hulumtimi 14

2.3. Korniza legjislative dhe e politikave 16

2.4. Informata të përgjithshme 19

3. Analizë e të dhënave të grumbulluara në terren | 23

3.1. Procesi i riatdhesimit 23

3.2. Banimi 24

3.3. Programet e ndihmës 27

3.4. Edukimi 31

3.5. Shëndetësia 32

3.6. Regjistrimi 33

3.7. Punësimi 33

4. Konkludime | 35

5. Rekomandimet | 37

6. Referencat | 39

Shtojca 1 – Pyetësor | 41

Shkurtesat dhe akronimet

KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
ECMI Kosovë	Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave, Kosovë*
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KKR	Komisioni Komunal për Riintegrim
MASHT	Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji
ZKKK	Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete
ZR	Zyra për Riintegrim
UNHCR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
URA 2	Projekt për kthim

Listë e figurave

- Figura 1:** Datat e riadhesimit të familjarëve të ekonomive familjare të anketuara – 14
- Figura 2:** Numri i familjarëve të riadhesuar në secilën ekonomi familje të anketuar – 15
- Figura 3:** Vendi nga ku janë kthyer dhe mënyra e riadhesimit – 15
- Figura 4:** Përqindja e familjeve të riadhesuara të pritura nga institucionet në aeroport – 24
- Figura 5:** Arsyeja për mosposedim të pronës – 25
- Figura 6:** Familjet e riadhesuara të cilave u është ofruar banim i përkohshëm – 26
- Figura 7:** Kohëzgjatja e banimit të përkohshëm të siguruar – 27
- Figura 8:** Numri i personave të riadhesuar që do të përfitojnë nga asistenca – 28
- Figura 9:** Kohëzgjatja e ndihmës me artikuj ushqimorë dhe higjienikë – 28
- Figura 10:** Niveli i kënaqshmërisë me shërbimin – 29
- Figura 11:** Institucioni/Organizata që e regjistroi familjen e riadhesuar – 30
- Figura 12:** Kënaqshmëria me Zyrën komunale për komunitete dhe kthim – 31
- Figura 13:** Pjesëmarrja e fëmijëve të familjeve të riadhesuara në programe të gjuhës – 32
- Figura 14:** Punësimi – 33

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve për status dhe në përputhje me RKS KB 1244/99 dhe opinionin e GJND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Përmbledhje ekzekutive

Banimi dhe shërbimet publike mbeten sfidat kryesore me të cilat përballen personat e kthyer në Kosovë. Sfidat e riintegrit janë më të vështira për të kthyerit nga komunitetet pakicë. Ky raport fokusohet në situatën e personave të kthyer nga komuniteti rom dhe ashkali në Komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje në Kosovën qendrore. Studimi bazohet në anketën e realizuar në periudhën mars dhe prill 2013 me 18 ekonomi familjare nga këto komunitete pakicë dhe intervistat e zhvilluara me zyrtarë komunalë.

Hulumtimi tregoi se shumë persona të riatdhesuar nga komuniteti rom dhe ashkali nuk kanë mundur të kthehen në vendet e tyre të prejardhjes dhe se shumica e tyre jetojnë tek të afërmit ose janë të vendosur nëpër banesa me qira me përkrahjen e qeverisë. Ndonëse shumica e familjeve të riatdhesuara të anketuara kanë pranuar dru zjarri, ushqime dhe artikuj higjienikë, ata i konsiderojnë programet aktuale të ndihmës si joadekuate për nevojat që kanë.

Pavarësisht nga përpjekjet për t'i integruar fëmijët e kthyer në shkolla me programe të gjuhës, ende ka sfida, veçanërisht për sa i përket rezistencës nga prindërit. Papunësia mbetet si çështje shumë shqetësuese dhe hulumtimi gjeti se nuk ka pasur përpjekje nga komunat për ta adresuar këtë çështje, madje as trajnime të organizuara, pavarësisht nga fakti se të tillat kërkohen me strategjinë dhe legjislacionin gjegjës. Dokumentacioni është gjithashtu një sfidë e madhe për personat e riatdhesuar, posaçërisht kur bëhet fjalë për regjistrim. Hulumtimi tregon edhe një mungesë të dijes nga radhët e personave të riatdhesuar për të drejtat e ndryshme që ata gëzojnë, si dhe ndihmën dhe programet në të cilat kanë të drejtë.

1. Hyrje

Në dekadën e fundit, Kosova ka parë një numër të madh të riatdhesimeve që kanë prekur me mijëra familje të kthyer dhe fëmijët e tyre çdo vit.¹ Kjo është trashëgimi e një konflikti që ka shkaktuar zhvendosjen e gati gjysmës së popullatës vendore,² dhe rezultat direkt i një numri marrëveshjesh për ripranim të nënshkruara nga Kosova që nga viti 2008. Në mënyrë alarmuese, statistikat e UNHCR-së kanë treguar për një rritje të qëndrueshme në numrin e riatdhesimeve me forcë të personave nga Kosova të përkatësishë etnike rome, ashkali, egjiptiane dhe serbe. Statusi i tyre si pakicë i vështirëson më tej sfidat për riintegrim.

Për të siguruar një kornizë të duhur legjislativë për riintegrimin e këtyre komuniteteve, qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, plan ky i hartuar në vitin 2008 nga një panel ekspertësh të udhëhequr nga UNMIK-u. Strategjia për riintegrim u rishikua në maj të vitit 2010, pasi u sfida efikasiteti i zbatimit të saj, por megjithatë i kushtoi vëmendje komuniteteve pakicë. Veç kësaj, Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës u miratua në dhjetor 2008, duke i përvijuar angazhimet riintegruese për shtatë vitet vijuese. Kjo dhe dispozita të tjera ligjore si Kushtetuta e Kosovës, Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe fushëveprimi i Këshillit

- 1 UNHCR, 2012. *Pasqyrë e përgjithshme statistikore: Përditësuar në fund të shtatorit 2012*. [pdf] Prishtinë: UNHCR Zyra e Kryesuesit të Misionit. Gjetet në: <[http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/\(httpDocuments\)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/\\$file/Statistical+overview+September+2012.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/(httpDocuments)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/$file/Statistical+overview+September+2012.pdf)> [qasur në maj 2013].
- 2 "Deri në fund të prillit 1999, afërsisht 600,000 banorë të Kosovës ishin refugjatë; afërsisht 400,000 ishin të zhvendosur brenda Kosovës", Lajmet e Migrimit, 1999. *Refugjatët Kosovarë*. [online] Gjetet në: <http://migration.ucdavis.edu/mn/more.php?id=1801_0_4_0> [qasur në maj 2013].

Konsultativ për Komunitete (KKK), theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të qytetarëve pavarësisht nga etnia ose origjina e tyre.

Një sfidë kyçe për riintegrimin e personave të riatdhesuar mbetet ajo e banimit dhe disponueshmërisë së shërbimeve gjegjëse publike. Në qershor 2012, hyri në fuqi Rregullorja 10/2012 me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i strategjive të qeverisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Në mesin e dispozitave tjera, ajo përvijon përgjegjësitë e Këshillit Komunal për Riintegrim (KKR) dhe Zyrës për Riintegrim (ZR).³ Rregullorja, që është shumë e rëndësishme, siguron qasje efektive në shërbime publike dhe përfitime të ndryshme për personat e riatdhesuar për të siguruar riintegrimin e tyre të qëndrueshëm.

Mungesa e banimit dhe qasjes në shërbime publike ka ndikim të rëndë e negativ në integrimin e komuniteteve të riatdhesuara. Ky studim fokusohet në sfidat e riintegrit, duke e adresuar diskrepancën ndërmjet kornizës së politikave dhe gjendjes aktuale. Riintegrimi i qëndrueshëm është prioritet shumë i lartë për institucionet e Kosovës dhe komunat duhet të inkurajojnë ndryshimin pozitiv afatgjatë dhe stabilitetin që do të vinte me përkrahjen e siguruar në fushën e strehimit dhe qasjen në shërbime publike.

Ky raport përmban pesë kapituj. Hyrja paraqet metodologjinë e hulumtimit, kornizën relevante legjislativë dhe të politikave, si dhe çështjet në sfond. Pjesa vijuese prezanton të dhënat e grumbulluara në fushën që ka të bëjë me strehimin, procesin e riatdhesimit, shëndetësinë, regjistrimin dhe punësimin. Dy kapitujt e fundit paraqesin konkluzione dhe rekomandime që dalin nga hulumtimi.

1.1. Objektivat e hulumtimit

Ky hulumtim synon të vlerësojë shkallën e integrit të komuniteteve të riatdhesuara në Kosovë/Kosovo Polje duke e parë zbatimin e politikave të riatdhesimit në fushën e banimit dhe qasjes në shërbimet përkatëse publike. Hulumtimi synon të përdorë metoda kuantitative dhe kualitative për t'i identifikuar zbrazëtitrat ndërmjet standardeve ligjore dhe situatën aktuale për komunitetet e riatdhesuara dhe gjithashtu të analizojë pengesat në marrjen apo përfitimin e banimit dhe shërbimeve publike për personat e riatdhesuar në Kosovë. Rezultatet e këtij hulumtimi janë vënë në përdorim për të nxjerrë rekomandime për atë se si të adresohen këto pengesa dhe zbrazëtitrat ekzistuese ndërmjet politikave dhe zbatimit lokalë. Raporti synon gjithashtu të ngritë vetëdijësimin ndërmjet hisedarëve relevantë përkritazi me gjetjet e hulumtimit.

3 "ZKKK, Zyra për Riintegrim dhe institucionet e tjera të përfshira në procesin e regjistrimit janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve." Rregullorja nr. 10/2012 për Menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2012.

Metodologjia

Hulumtimi është shërbyer me qasje kuantitative dhe kualitative. Pyetësi ka kontribuar në veçanti ashtu që të dhënat kualitative dhe ato kuantitative t'i adresojnë çështjet lidhur me raportin ndërmjet riatdhesimit ose statusit si pakicë dhe qasjen e kufizuar në shërbime publike dhe banim. Intervistat me institucionet e Kosovës kanë siguruar të dhëna kualitative dhe kuantitative shtesë.

2.1. Hulumtimi preliminar dhe grumbullimi i të dhënave

Faza e parë bazohet në hulumtim e bërë nga zyra dhe shqyrtimin e literaturës me qëllim të zhvillimit të një kuptimi më të avancuar të ligjeve dhe praktikave lokale dhe ndërkombëtare, të ndërtimit të një kornize hipotetike lidhur me riatdhesimin dhe qasjen në shërbime, identifikimit të hisedarëve gjegjës duke përfshirë ministrinë dhe institucionet, si dhe identifikimit të burimeve të të dhënave statistikore të nevojshme për hulumtim kuantitativ dhe çështjeve potenciale për hulumtim kualitativ. Pas hulumtimit preliminar janë intervistuar personat e riatdhesuar nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Hulumtuesit e plotësuan pyetësin gjatë intervistave. Intervistat u zhvilluan në mes muajit mars dhe prill 2013 me institucionet relevante të Kosovës dhe përfaqësues të Komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.⁴


4 Intervista janë mbajtur në Komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje me: Halil Qerimi (ZKKK zyrtar për edukim), Muharrem Berisha (ZKKK zyrtar për zhvillim) dhe Hysen Sllamniku (ZKKK zyrtar për kthim dhe anëtar i Komisionit komunal për riatdhesim në Fushë Kosovë/Kosovo Polje).

2.2. Mostër hulumtimi

Fushë Kosova/Kosovo Polje u zgjodh si fokus i hulumtimit, meqë aty jeton afërsisht 11% e popullatës rome, ashkali dhe egjiptiane e Kosovës.⁵ Këto grupe etnike konsiderohen nga UNHCR si grupe në rrezik.⁶ Vlen të përmendet gjithashtu se Fushë Kosova/Kosovo Polje ishte komuna e parë në Kosovë që ka miratuar *Planin komunal të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian* si rezultat i angazhimit të organizatave lokale të shoqërisë civile.

Për shkak të burimeve të kufizuara është zgjedhur një mostër hulumtimi për lehtësi. Hulumtuesi lokal i ka pasur për cak hulumtimi ato familje të persona-ve të riatdhesuar në komunë që ishin lehtësisht të arritshme dhe informacionet e grumbulluara nga OJQ-të, OSHC-të dhe zyrtarët komunalë e përcaktuan përzgjedhjen e pjesëmarrësve në hulumtim. Hulumtimi kishte për cak personat e riatdhesuar që janë kthyer në Kosovës nga viti 2010 deri 2012 (shih figurën 1) dhe asnjë nga ata që ishin pjesë e hulumtimit nuk u larguan nga Kosova për herë të dytë.

Figura 1: Datat e riatdhesimit të famililjarëve të ekonomive familjare të anketuara




5 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012. *Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Rezultatet përfundimtare*. [pdf] Prishtinë/Prishtina: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gjetendet në: <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/QA_Raporti_ENG.pdf> [qasur në maj 2013].

6 Shih UNHCR, 2009. *Eligibility Guidelines for Assessing the International Protection Needs of Individuals from Kosovo*. [pdf] Prishtinë/Prishtina: UNHCR, Zyra e kryesuesit të misionit. Gjetendet në: <http://www.refworld.org/pdfid/4af842462.pdf> [qasur në maj 2013]; dhe UNHCR, 2012. *Pasqyrë e përgjithshme statistikore: Përditësuar në fund të shtatorit 2012*. [pdf] Prishtinë/Prishtina: UNHCR Zyra e kryesuesit të misionit. Gjetendet në: <[http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/\(httpDocuments\)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/\\$file/Statistical+overview+September+2012.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/(httpDocuments)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/$file/Statistical+overview+September+2012.pdf)> [qasur në maj 2013].


Mostra e hulumtuar përfshinte në total 18 ekonomi familjare të personave të riadhesuar, duke përfshirë 14 ekonomi familjare nga komuniteti ashkali dhe 4 ekonomi familjare nga komuniteti rom. Mesatarja e numrit të familjarëve të riadhesuar për ekonomi familjare ishte 3.4 dhe sillej nga një e deri në tetë persona (shih Figurën 2).

Figura 2: Numri i familjarëve të riadhesuar në secilën ekonomi familjare të anketuar



Të gjithë personat e riadhesuar që janë anketuar nga komuniteti rom dhe ashkali vinin nga vendet Evropiane, me përjashtim të një familjeje që u kthye nga Bosnja dhe Hercegovina. Gati gjysma e këtyre kthimeve (shtatë) ishin riadhesime me forcë (shih Figurën 3).

Figura 3: Vendi nga ku janë kthyer dhe mënyra e riadhestimit



2.3. Korniza legjislative dhe e politikave

Të drejtat dhe mbrojtja që u është dhënë personave të riatdhesuar udhëhiqen nga parimet ndërkombëtare të barazisë dhe mosdiskriminimit – të kthyerit duhet t'i gëzojnë të njëjtat të drejta si të gjithë qytetarët tjerë. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës, *Ligji për përdorimin e gjuhëve* dhe *Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë*, e theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të të gjithë qytetarëve pavarësisht nga etnia ose origjina e tyre. E drejta e të gjithë personave për t'u kthyer në shtëpitë e tyre të sigurt dhe me dinjitet, e drejta për kushte adekuate të banimit dhe kthim të pronës njihen nga standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejta të njeriut.⁷ Këto standard formojnë bazën e politikave të Kosovës për kthim dhe riintegrim. Prandaj, nga institucionet e Kosovës kërkohet që të lehtësojnë kthimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur për në Kosovë.

Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë përcakton masa specifike të ndihmës për këto tre komunitete, duke përfshirë orë plotësuese për fëmijët e kthyer dhe orë të gjuhës.⁸

Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2009–2013) e thekson fuqishëm zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e komuniteteve joshumicë, duke synuar mundësimin dhe inkurajimin e kthimit të qëndrueshëm të popullsisë së zhvendosur.

Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar e miratuar nga Republika e Kosovës në maj 2010 përcakton politikat dhe masat që duhet të ndërmerren për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme për personat e riatdhesuar në të gjitha aspektet e riintegrit: ndihma fillestare në pranim, regjistrimi civil, shëndetësia, shkollimi, punësimi mirëqenia sociale., çështjet e lidhura me banim dhe pronë. Ajo siguron një kornizë institucionale për menaxhimin e pranimit dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe i përkufizon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe komunale gjatë gjithë procesit të riintegrit. Kujdes i veçantë i është kushtuar nevojave të komuniteteve joshumicë dhe grupeve të cënueshme. Synimi kryesor i Strategjisë së rishikuar është që të mbështes riintegrimin socio-ekonomik të personave të riatdhesuar duke i lehtësuar mundësitë për qasje në punësim dhe skemat sociale në dispozicion. Për më tepër, Strategjia e rishikuar parasheh regjistrimin në institucione shëndetësore të personave të riatdhesuar si dhe sigurim e kartelave shëndetësore. Shumë me rëndësi, Strategjia

7 Shih, për shembull, neni 8 i KEDNJ-së (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), neni 14 (ndalimi i diskriminimit), neni 1, Protokoll 1 (E drejta në pronë) dhe neni 2, Protokoll 4 (Liria e lëvizjes); dhe gjithashtu Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKCP) neni 12(4) (E drejta për kthim në vendin e origjinës) Shih gjithashtu, 'Parimet për banim dhe kthim të pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur' miratuar nga Nënkomisioni i OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut më 11 gusht 2005, E/CN.4/Sub.2/2005/17.

8 *Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës (2009–2015)*, dhjetor 2008.

parasheh lirimin nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në kohën kur të arrihet integrimi i plotë (varësisht nga statusi social).⁹

Rregullorja për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Rregullorja) përcakton kriteret kualifikuese për programin e riintegrit dhe përfitimet për personat e riatdhesuar dhe është shumë e rëndësishme për ruajtjen e të drejtave të personave të riatdhesuar.

Rregullorja i përcakton përgjegjësitë e organeve kompetente, si dhe të drejtat dhe mundësitë në dispozicion për personat e riatdhesuar lidhur me arritjen, banimin, shëndetin, ndihmën dhe punësimin.

Arritja në Kosovë

Sipas Rregullores, personave të riatdhesuar duhet të ju sigurohet transporti i organizuar nga pika e arritjes e deri tek destinacioni.¹⁰ Zyra për riintegrim krahas Zyrës për pranim në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës është përgjegjëse për organizimin e pranimit të personave të riatdhesuar në aeroport dhe vendkalimet tjera kufitare. Zyra për riintegrim është përgjegjëse për t'i informuar personat e riatdhesuar pas arritjes në Kosovë për të drejtën e tyre për të marrë pjesë në programe për riintegrim dhe gjithashtu për t'ju siguruar transportim deri në destinacion.¹¹

Banimi

Rregullorja u siguron personave të riatdhesuar të drejtën (në arritje) për strehim të përkohshëm deri në shtatë ditë.¹² Për më tepër, personave të riatdhesuar mund të përfitojnë nga e drejta për sigurim të banimit përmes qirasë së tregut me bonus banimi për një periudhë 6 mujore me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj.¹³ Kjo është në dispozicion për familjet e riatdhesuara që nuk kanë cilat nuk kanë bane-së apo shtëpi në pronësi individuale, ose që kanë mbetur pa shtëpi ose pronësi si rezultat i dëmeve në shtëpi të shkatëruara nga lufta e fundit në Kosovë. Çdo familje e riatdhesuar që kualifikohet për strehim të përkohshëm gëzon, me automatizëm, të drejtën për sigurim të banimit përmes qirasë së tregut me bonus banimi për një periudhë 6 mujore me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj.¹⁴ Për më tepër, rregullorja siguron edhe mundësinë e renovimit ose rindërtimit të shtëpive.¹⁵

9 *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar*, maj 2010, f.16.

10 *Rregullorja Nr. 10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar*, neni 15 (1.1).

11 Po aty, Neni 7.

12 Po aty, Neni 15 (1.2).

13 Po aty, Neni 15 (2.3).

14 Po aty, Neni 16 (1.3).

15 Po aty, Neni 15 (2.5).

Shëndeti

Personat e riatdhesuar kanë të drejtë në shërbime mjekësore emergjente, nëse një gjë e tillë është e nevojshme kur të arrijnë.¹⁶ Në bazë të kriterëve për përfitime emergjente, personat e riatdhesuar mund gjithashtu të kenë qasje në trajtim shëndetësor dhe medikamente.¹⁷ Asistenca mjekësore mund të ofrohet për gjashtë muaj me mundësi të zgjatjes së kësaj periudhe edhe për gjashtë muaj tjerë.¹⁸ Megjithatë, asistenca mjekësore i nënshtrohet kriterëve për kualifikim dhe nuk është e garantuar gjerësisht.

Pakot e ndihmës

Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR) është përgjegjës për identifikimin e nevojave të personave të riatdhesuar në një komunë përkatëse dhe për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për aplikimet e personave të riatdhesuar për artikuj ushqimorë dhe higjienikë, strehim/banim, ndihmë mjekësore, ndihmë materiale, ndihmë me mobile shtëpie dhe ndihmë dimërore.¹⁹

Rregullorja garanton të drejtën në pako të ndihmës me artikuj ushqimorë dhe higjienikë deri në gjashtë muaj²⁰ për personat e riatdhesuar me familje në kushte të vështira socio-ekonomike që kanë nevojë për ndihmë të tillë dhe familjet që fitojnë të drejtën në strehim të përkohshëm deri në shtatë ditë kualifikohen automatikisht në këtë përfitim.²¹ Ndihamat ushqimore ndahen për person dhe ka fleksibilitet nëse ka kërkesë në baza shëndetësore.

Një mundësi për ndihmë me mobile deri në €2,000 (€1,000 për individ) ofrohet për personat e riatdhesuar të cilët kanë mungesë të mobileve të mjaftueshme. Pakoja e harmonizuar e ndihmës me ndihmë ofron, për shembull, një frigorifer, deri në katër shtretër shumëpërdorimësh dhe një lavaman kuzhine për një familje.²² Ngjashëm, pakot me ndihmë materiale përfshijnë, për shembull, një batanije për person dhe varen nga madhësia e familjes dhe nevojat e posaçme të grave dhe fëmijëve të vegjël (d.m.th. peceta sanitare apo pelena për foshnja).²³ Asistenca dimërore garantohet për familjet e riatdhesuara në bazë të gjendjes së vështirë socio-ekonomike dhe përbëhet nga 5m² të druve të zjarrit për familje.²⁴

16 Po aty, Neni 15 (1.3) dhe (2.1).

17 Po aty, Neni 15 (2.1).

18 Po aty, Neni 16 (1.2.4).

19 Po aty, Neni 6.

20 Po aty, Neni 15 (2.1).

21 Po aty, Neni 16 (1.1.1) dhe (1.1.2).

22 Po aty, Neni 16 (1.7).

23 Po aty, Shtojca 3.

24 Po aty, Neni 16 (1.6.1).

Gjithashtu, ekziston asistenca e kohëpaskohshme *ad hoc* që do të ofrohet sipas nevojës, pas vlerësimit nga autoritete përkatëse komunale dhe përmes bashkëveprimit me palë përkatëse të interesit.²⁵

Shkollimi

Të gjithë fëmijët e riatdhesuar kanë të drejtë në shkollim dhe të drejta të barabarta sikurse nxënësit tjerë në sistemin shkollor të Republikës së Kosovës.²⁶ Rregullorja përcakton se duhet të ofrohen kurse të gjuhëve për fëmijët e riatdhesuar “në mënyrë që këta fëmijë ta mësojnë gjuhën e tyre amtare dhe të arrijnë të njëjtin nivel me fëmijët e shkollave ku ata do ta vijojnë mësimin.”²⁷ KKR është përgjegjës për vlerësimin e nevojës në një komunë përkatëse për kurse gjuhësore shtesë dhe për lehtësimin e qasjes në shkollim. Në mungesë të dokumenteve, nxënësit e riatdhesuar lejohen të vijojnë mësimin me kusht që të dorëzojnë dokumentacionin sa më parë.²⁸

Punësimi

Rregullorja përcakton aftësimin profesional, ndihmën për punësim dhe ndihmën në zhvillimin e projekteve për gjenerimin e të ardhurave.²⁹ Gjithashtu, ajo parasheh trajnime të aftësimit profesional për personat e riatdhesuar që përmbushin kriteret bazike të pranueshmërisë, dhe atyre që vlerësohet se janë në gjendje t’i rrisin gjasat për punësim të qëndrueshëm nga organet kompetente përmes trajnimeve të tilla.³⁰ Rregullorja përcakton që KKR është përgjegjës për identifikimin e mundësive për ofrimin e trajnimeve të aftësimit profesional dhe qasjen në tregun e punës. Të gjithë personat e riatdhesuar që i përmbushin kriteret të cilët nuk kanë përfituar nga projekte tjera të gjenerimit të të ardhura kanë të drejtë të qasjes në këto projekte. Aplikuesit duhet të dorëzojnë një plan të biznesit krahas formularit për aplikim dhe dokumenteve tjera përkatëse.³¹

2.4. Informata të përgjithshme

Sipas statistikave të UNHCR, në periudhën ndërmjet janarit 2010 dhe shtatorit 2012 kanë qenë 18,455 kthime të personave me prejardhje nga Kosova nga të

25 Po aty, Neni 16 (1.4).

26 Po aty, Neni 16 (2).

27 Po aty, Neni 15 (3.1).

28 Po aty, Neni 16 (2).

29 Po aty, Neni 15 (3.2)(3.3)(3.4).

30 Po aty, Neni 16 (3.2).

31 Po aty, Neni 16 (5).

gjitha shtetet (duke përfshirë kthime vullnetare, të ndihmuara dhe me forcë) të komunitetit shumicë dhe pakicë. Sipas UNHCR, gjithsej ishin 3,796 kthime më 2012, dhe statistikat tregojnë një trend në zbritje (8,507 më 2010 dhe 6,152 më 2011). Viteve të fundit, shtetet që kanë akomoduar numra të mëdhenj të personave të zhvendosur nga Kosova gjithnjë e më shumë kanë kërkuar kthimin e tyre në Kosovë, dhe kthimet me forcë gjithnjë e më shumë kanë përfshirë personat që i përkasin komunitetit joshumicë, duke përfshirë romë, ashkali dhe egjiptianë. Në vitin 2012 kanë qenë 434 kthime me forcë dhe 311 vullnetare nga shtetet e treta (kryesisht nga Evropa perëndimore) të pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.³²

Përkundër angazhimit afatgjatë të institucioneve të Kosovës dhe aktorëve ndërkombëtarë, personat e riadhesuar, posaçërisht ata që i përkasin komuniteteve joshumicë, vazhdojnë të përballen me pengesa të mëdha në riintegrimin e qëndrueshëm për shkak problemeve me drejta në banim dhe pronë dhe vështirësi në qasjen në shërbime bazike siç është shkollimi, kujdesi shëndetësor, asistencë sociale, punësimi dhe mundësitë ekonomike.

Mungesa e qasjes në banim dhe akomodim për persona të riadhesuar vazhdon të jetë pengesa kryesore në kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm. Në shumë raste, pronat janë shkatërruar gjatë konfliktit apo janë sjellë në gjendje të pabanueshme pas periudhave të gjata të mungesës. Konflikti ka detyruar shumë njerëz që të braktisin shtëpitë e tyre dhe, në mungesë të tyre, shtëpitë u janë marrë dhe okupuar nga të tjerët. Shumë romë, ashkali dhe egjiptianë kanë mungesë të dokumentacionit adekuat pronësor.³³ Përveç kësaj, një problem madhor për shumë persona të kthyer që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është statusi i tyre i paqartë dhe i pasigurt ligjor për sa i përket banimit, duke përfshirë çështje që kanë të bëjnë me pronësinë e tokës dhe mungesën e titujve të regjistruar të pronave të tyre.³⁴

Riintegrimi i fëmijëve të kthyer në sistemin kosovar vazhdon të jetë një sfidë tjetër e vështirë, posaçërisht për sa i përket gjuhës. Shumë fëmijë të kthyer kanë njohuri të pamjaftueshme të gjuhës shqipe apo serbe si rrjedhojë e të qenit jashtë vendit për shumë vite apo mund të mos kenë qenë asnjë në vijim të shkollimit, dhe rrjedhimisht përballen me vështirësi me vijimin e orëve

32 UNHCR, 2012. *Pasqyrë statistikore: Azhurnim në fund të shtatorit 2012*. [pdf] Prishtinë: UNHCR Zyra e Shefit të Misionit. Në dispozicion në: <[http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/\(httpDocuments\)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/\\$file/Statistical+overview+Septemb er+2012.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/(httpDocuments)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/$file/Statistical+overview+Septemb er+2012.pdf)> [kontrolluar në maj 2013].

33 OSBE, 2011. *Realizimi i Planit të Veprimt për Strategjinë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë*, maj 2011. [pdf] Prishtinë: Misioni i OSBE-së në Kosovë. Në dispozicion në: <<http://www.OSBE.org/kosovo/77413>> [kontrolluar në maj 2013]. f. 9.

34 Po aty, f. 11.

të mësimet.³⁵ Përderisa gjuha amtar e komunitetin rom është gjuha rome, familjet e kthyer rome në veçanti preferojnë më shumë shkollimin në gjuhën serbe sesa shqipe, që krijon një sfidë shtesë për qasjen në shkollim.³⁶ Situata e shkollimit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë karakterizohet me vijueshmëri të ulët dhe braktisje të lartë, posaçërisht nga vajzat. Hulumtimi i kryer nga ECMI Kosovë në Fushë Kosovë ka gjetur monitorim jo-adekuat të statistikave të fëmijëve të kthyer dhe mungesë të buxhetit specifik komunal që ka për synim shkollimin e të kthyerve.³⁷ Problemet tjera përfshijnë adaptimin me sistemin shkollor në Kosovë dhe nivele të ndryshme akademike,³⁸ si dhe probleme me krijimin e miqësive të reja dhe përshtatjes me ta. Ka edhe probleme tjera me sigurimin e dokumenteve të nevojshme për regjistrim (p.sh. certifikata të lindjes dhe pranimi i diplomave apo certifikatave të lëshuara në vendet tjera).³⁹

Sfidat me të cilat përballen personat e riadhesuar në qasjen e kujdesit shëndetësor kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e dokumenteve personale për regjistrim në institucionet shëndetësore, regjistrat jo të plotë mjekësorë, kostoja relativisht e lartë e trajtimit dhe qasja e dobët në kujdes shëndetësor në vishet rurale.⁴⁰

Dokumentet civile janë thelbësore për t'i gëzuar dhe ushtruar të drejtat themelore në Kosovë, duke përfshirë qasjen në shkollim, kujdes shëndetësor dhe ndihmë sociale. Të kthyerit mund t'i kenë humbur certifikatat apo dokumentet e tyre jashtë vendit dhe mund të përballen me vështirësi në sigurimin e një kopje të certifikuar pas kthimit. Mungesa e regjistrimit civil mund të ketë pasoja të rënda për personat e riadhesuar. Pa regjistrim të duhur civil, individët mund të përballen me pengesa të konsiderueshme në riintegrim dhe të mos kenë fare apo të kenë qasje të kufizuar në shërbime komunale, kujdes shëndetësor, shkollim, shërbime sociale, punësim dhe mundësi të tjera. Kjo situatë është posaçërisht shqetësuese për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, meqë ata përballen me sfida shtesë në regjistrimin civil për shkak të mungesës së dokumenteve.⁴¹

35 ECMI Kosovë, 2012. *Studim bazë: Ofrimi i shkollimit për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës*. [pdf] Në dispozicion në: <http://www.ecmikosovo.org/images/pdf/Baseline_Study_ENG_for_print.pdf> [kontrolluar në maj 2013]. f. 11.

36 Po aty, f. 11.

37 Po aty, f. 27.

38 Këshilli Danez për Refugjatë, 2008. *Rekomandimet për kthimin dhe riintegrimin e azilkërkuesve të refuzuar: Mësimet e nxjerra në Kosovë*. [pdf] Në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/pdfid/484022172.pdf>> [kontrolluar në maj 2013]. f. 32.

39 OSBE, 2009. *Realizimi i Strategjisë për Integrimin e Personat e Riadhesuar të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat e Kosovës, nëntor 2009*. [pdf] Prishtinë: Misioni i OSBE-së në Kosovë. Në dispozicion në: <<http://www.OSBE.org/kosovo/40180>> [kontrolluar në maj 2013]. f. 8.

40 Po aty, f. 8.

41 Po aty, f. 9.

Personat e riatdhesuar në Kosovë përballen me perspektivë të dobët të punësimit dhe kushte të vështira socio-ekonomike. Papunësia është posaçërisht shqetësuese për personat e riatdhesuar, dhe personat nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian janë në pozitën më të pafavorshme dhe më të diskriminuar.⁴² Megjithatë, përkundër shkallës së larë të papunësisë, këta pjesëtarë të komuniteteve shpeshherë gjejnë punë me pagë të ulët dhe punësim joformal.

42 Po aty, f. 10.

3. Analizë e të dhënave të grumbulluara në terren

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKM) në Fushë Kosovë ka konfirmuar se kanë qenë 168 persona të riatdhesuar të vërtetuar që nga viti 2010 (nga të gjitha komunitetet),⁴³ nga të cilët 90 persona ishin romë, ashkali dhe egjiptianë.⁴⁴ ZKKM theksoi se nuk kishte bazë të saktë të të dhënave për numrin e familjeve apo ekonomive familjare të riatdhesuara; në vend të saj, informatat e mbledhura nga ZKKM janë për persona individualë të riatdhesuar.

3.1. Procesi i riatdhesimit

Arritja në Kosovë


shumica e ekonomive familjare të riatdhesuara të përfshira në anketë për këtë hulumtim (61%) janë pritur nga institucionet e Kosovës në aeroport, por 33 për qind jo (Figura 4). Një pjesëmarrës në hulumtim kishte arritur me veturë nga Bosnja dhe Hercegovina. 44 për qind (8 nga 18) të personave të riatdhesuar janë ndihmuar me transport pas arritjes në Kosovë; dy prej tyre janë pritur nga familja në aeroport; dhe një tjetër ka arritur me veturë. Sipas ZKKM, të drejtat e personave të riatdhesuar promovohen vetëm përmes broshurave dhe informatave

43 Po aty.

44 Po aty.

të pranuar pas arritjes në aeroport.⁴⁵ ZKKM gjithashtu zakonisht kryen vizita në shtëpi.⁴⁶ Informatat për ndihmën dhe të drejtat për personat e riadhesuar duhet të sigurohen në aeroport dhe formularët e plotësuar të dërgohen në ZKKM në baza javore dhe dyjavore.⁴⁷ ZKKM gjithashtu kryen vizita komunikuese nëpër shtëpi për personat e riadhesuar.

Figura 4: Përqindja e personave të riadhesuar të pritur nga institucionet në aeroport



3.2. Banimi

Gjendja me banim pas kthimit

50 për qind të ekonomive familjare të riadhesuara që janë anketuar nuk janë kthyer në vendin e tyre të prejardhjes në Kosovë dhe, të gjitha, asnjë pjesëmarrës i komunitetit rom nuk është kthyer. Ndonëse një familje është kthyer në vendin e tyre të prejardhjes në Shtime, familja është zhvendosur në Fushë Kosovë vetëm një muaj më vonë.


45 Intervistë: Halil Qerimi (Zyrtar për arsim ZKKM), Muharrem Berisha (Zyrtar për zhvillim ZKKM), dhe Hysen Silamniku (ZKKM zyrtar për kthim dhe anëtar i Komisionit Komunal për Riadhesim në Fushë Kosovë).

46 Po aty.

47 Po aty.

Vetëm një nga personat e riadhesuar që janë anketuar kishte në pronësi një banesë pas kthimit në Kosovë. Shumica e personave të riadhesuar asnjëherë nuk kanë pasur prona të tyre, ndonëse në një rast familja e kishte shitur pronën. 20 për qind e personave të riadhesuar kanë humbur shtëpinë e tyre si pasojë e luftës, qoftë nga shkatërrimi pas vitit 1999 apo uzurpimi (shih Figurën 5).

Figura 5: Arsyeja për mungesë të shtëpise pas kthimit



Akomodimi dhe mbështetja aktuale

Shumica e personave të riadhesuar janë gjetur të jetojnë në banime me qira (Figura 6), por të gjitha⁴⁸ janë përgjigjur se familja e tyre nuk mund ta përballojë pagesën e qirasë. Megjithatë, ky studim ka gjetur se Qeveria e Kosovës ka subvencionuar 100 për qind të qirasë për 56 për qind të personave të riadhesuar që janë anketuar.⁴⁹ Të gjitha familjet e riadhesuara që janë anketuar e që jetojnë me qira kanë pranuar mbështetje financiare, por ata që jetojnë me të afërmit e tyre nuk e kanë pranuar këtë mbështetje, edhe nëse janë obliguar të paguajnë qira dhe përkundër vështirësive financiare. ZKKM ka konfirmuar se nëse një person i riadhesuar jetonte me familjen, nuk është ofruar fare mbështetje për qira.⁵⁰ Sipas ZKKM në Fushë Kosovë, banimi është ofruar 16 familjet e kthyer. Që nga viti 2010, 21 raste kanë pranuar banim (strehim) dhe ndihmë financiare për të mbuluar qiranë që sillej ndërmjet €70 dhe €200 (varësisht nga madhësia e familjes, lokacioni, rehatia).⁵¹

48 00 për qind përfshirë ata që jetojnë në shtëpi të të afërmeve.

49 Për më tepër, në rastin e dy personave të riadhesuar, qiraja është subvencionuar në të kaluarën, po ashtu në 100 për qind.

50 Po aty.


51 Po aty.

Programi i banimit të përkohshëm

Pesëdhjetetë për qind (58%) të familjeve të riatdhesuara janë përgjigjur se kanë përfituar nga programi i banimit të përkohshëm në Kosovë (Figura 6).

Përveç një rasti, banimi i përkohshëm është ofruar për së paku gjashtë muaj. Pesëdhjetë për qind (50%) të personave të riatdhesuar u është ofruar akomodim i përkohshëm për së paku një vit, mbi gjashtë muajt minimale të obliguara me ligj (Figura 7). Sipas ZKKM, nëse shtëpia e personit të riatdhesuar është shkatërruar, dhe aprovohet ndërtimi i shtëpisë, banimi i përkohshëm do të ofrohet deri në finalizimin e shtëpisë së re.⁵²


Figura 6: Familjet e riatdhesuara te cilave i eshte ofruar banim i perkohshem



Niveli i ndërgjegjësimit për programin e banimit të përkohshëm është shumë i ulët. Vetëm tri familje të riatdhesuara (16.6%) të cilat kanë përfituar, kishin dëgjuar më herët për këtë program. Ndryshe, asnjëri prej atyre që nuk kanë përfituar nga programi nuk kishin njohuri për ekzistimi e tij.

52 Po aty.

Figura 7: Kohezgjatja e banimit te perkohshem te ofruar



Ndërtimi dhe rinovimi i shtëpive

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për aprovimin e ndërtimit dhe rinovimit të shtëpive. Rastet për ndërtim apo rinovim të shtëpisë vlerësohen në bazë të dëshmimeve të dëmeve. Kriteret përfshijnë që familja duhet të ketë dokumentacion të pronës/tokës të regjistruar në emrin e tyre, apo emrin e familjarëve të ngushtë.⁵³ Kjo ndihmë prioritetizohet për familjet e riatdhesuara para individëve të riatdhesuar të cilët nuk kualifikohen për këtë ndihmë⁵⁴. Sipas ZKKM, Ministria e Punëve të Brendshme ka aprovuar ndërtimin e shtëpive për tetë familje, gjersa janë refuzuar gjashtë aplikacione. Dy nga shtëpitë e aprovuara janë përfunduar dhe gjashtë do të ndërtohen këtë vit. Për më tepër, ZKKM ka aprovuar rinovimin e dy shtëpive tjera, të cilat do të fillojnë këtë vit.⁵⁵

3.3. Programet e ndihmës

Komisioni Komunal për Riintegrim vendos për ndihmën në kuptim të ushqimit, higjienës, banimit të përkohshëm, medikamenteve, mobileve dhe druve të zjarrit, si dhe vendimet i merr bazuar në Rregulloren nr. 10/2012, neni 14.⁵⁶


53 Intervistë: Hysen Sllamniku (ZKKM zyrtar për kthim dhe anëtar i Komisionit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë).

54 Deri më sot nuk është aprovuar një ndihmë e tillë në rastin e një personi individual të riatdhesuar.

55 Intervistë: Halil Qerimi (Zyrtar për arsim ZKKM), Muharrem Berisha (Zyrtar për zhvillim ZKKM), dhe Hysen Sllamniku (ZKKM zyrtar për kthim dhe anëtar i Komisionit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë).


56 Po aty.

Figura 8: Numri i ekonomive familjare te riadhesuara qe do te perfitojnenga asistenca



Gati të gjitha ekonomitë familjare në këtë studim kanë raportuar se kanë pranuar artikuj ushqimorë dhe higjienikë (shih Figurën 8), dhe sipas ZKKM, 168 persona të riadhesuar në Fushë Kosovë kanë pranuar artikuj ushqimorë dhe higjienikë. Nga programet e ndihmës, ajo me ushqim dhe materiale higjienike ka marrë shkallën më të lartë të kënaqësisë në anketë. Në vetëm një rast kohëzgjatja e kësaj asistencë ishte më pak se gjashtë muaj, dhe 39 për qind kanë pranuar ndihmë për më se një vit (shih Figurën 9). Gati të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim kanë komentuar se do të dëshironin të shihnin përmirësime në ndihmën me artikuj ushqimorë dhe higjienikë dhe se ajo do të duhej të ofrohej për një periudhë më të gjatë kohore.

Figura 9: Kohëzgjatja e ndihmës me artikuj ushqimorë dhe higjienikë




Pesëdhjetë për qind (50%) e personave të intervistuar kanë pranuar ndihmë dimërore. ZKKM ka qartësuar se familjet e kualifikuara kanë pranuar ndihmë me dru zjarri deri në €200, vetëm një herë.⁵⁷ Asistenca dimërore ka pranuar shkallë të ulët të kënaqësisë që sillet nga ‘disi i pakënaqur’ dhe ‘i pakënaqur’. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se 5m2 dru për familje nuk është sasi e madhe duke pasur parasysh se druri do të përdoret edhe për ngrohje edhe për gatim.

Hulumtimi ka gjetur se vetëm dy nga personat e riadhesuar kanë pranuar ndihmë me mobile, dhe ZKKM ka konfirmuar se janë aprovuar 16 aplikacione por edhe nuk janë shpërndarë mbilet.⁵⁸

Nga radhët e personave të anketuar, disa persona të riadhesuar kanë theksuar se kanë pranuar thithëse elektrike dhe lavatriqe si dhe ndihmë të ad hoc. Ky hulumtim tregon një mungesë të kuptimit të programeve të ndryshme të ndihmës në dispozicion, d.m.th. ad hoc, materiale, dimërore dhe ushqimore. Kur janë pyetur për ndihmën ad hoc, dy ekonomi familjare të riadhesuara nga komuniteti rom kanë theksuar se janë vizituar nga televizioni gjerman ZDF (Zweites Deutsches Fernsehen) dhe Programi në Gjuhën Rome i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) në vend se të shpjegojnë ndihmën e pranuar. Sipas ZKKM, familjet e riadhesuara kryesisht kërkojnë traktorë të vegjël dhe disa persona kanë kërkuar mjete të punës, siç janë sharrat e drurit.⁵⁹

Figura 10: Shkalla e kënaqësisë me asistencen



57 Po aty.
58 Po aty.
59 Po aty.


Kërkesa për ndihmë

Gjithsej 77.8 për qind (14 nga 18) të familjeve të riatdhesuara kanë dorëzuar kërkesë tek institucionet kosovare për ndihmë – për rinovim shtëpish, ndërtim të shtëpisë së re, proces të gjenerimit të të ardhurave, apo regjistrim civil. Katër (4) familje të riatdhesuara kanë pranuar përgjigje brenda tre muajsh, dy (2) familje brenda gjashtë muajsh dhe një (1) familje brenda shtatë muajsh. Megjithatë, 38.9 për qind të atyre që kanë parashtruar kërkesë kurrë nuk kanë pranuar përgjigje nga institucionet.

Asistenca institucionale

Të gjithë personat e riatdhesuar të anketuar (100%) janë regjistruar në një institucion apo organizatë si persona të riatdhesuar, përveç regjistrimit në aeroport. Të gjithë personat e riatdhesuar duket se janë regjistruar në ZKKM. IOM dhe URA 2 janë gjithashtu aktive në këtë fushë. ZKKM është përgjegjëse për monitorimin e familjeve të riatdhesuara deri në riintegrimin e tyre të plotë.⁶⁰ Megjithatë, nuk ka përkufizim të qartë se çka do të thotë “integrim i plotë”. ZKKM ka cekur se në mungesë të një përkufizimi të qartë ajo thjesht i referohet Rregullores.⁶¹ Përfaqësuesi i ZKKM gjithashtu ka theksuar se për ata që nuk kanë pronë, ofrimi i ndihmës dhe monitorimit përfundon pas një viti.⁶²

Figura 11: Institucioni/organizata qw regjistron familja e riatdhesuar




60 Rregullorja nr. 10/2012, Neni 5 (1.7).

61 Intervistë: Halil Qerimi (Zyrtar për arsim ZKKM), Muharrem Berisha (Zyrtar për zhvillim ZKKM), dhe Hysen Sllamniku (ZKKM zyrtar për kthim dhe anëtar i Komisionit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë).

62 Po aty.

Përkundër njohjes së ZKKK-së nga personat e riadhesuar, niveli i kënaqshmërisë është mjaft i ulët; 27.8 për qind janë deri diku të pakënaqur, derisa 38.9 për qind janë të pakënaqur. Për brengosje është që Komiteti Komunal për Riintegrim (KKR) ishte i panjohur për të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim, përkundër rolit të tij thelbësor në ofrimin e ndihmës për personat e riadhesuar.⁶³ Megjithatë, vlen të theksohet që KKR-ja ka qenë funksional vetëm nga qershori 2012.

Figura 12: Kënaqshwria me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim



3.4. Edukimi


Shtatë nga familjet e riadhesuar kanë fëmijë të moshës së shkollës fillore, por vetëm katër familje kishin regjistruar fëmijët e tyre në shkollë kur ishin kthyer. Në tri nga këto raste, fëmijët ishin regjistruar menjëherë, derisa familja tjetër e riadhesuar, e cila kishte arritur në mars të vitit 2012, ishte regjistruar në shtator – gjashtë muaj pas arritjes. Dy nga familjet e riadhesuara nga komuniteti ashkali kishin theksuar që fëmijët e tyre nuk ishin regjistruar në shkollë pasi nuk flisnin gjuhën shqipe, derisa një familje tjetër nga komuniteti rom kishte theksuar që fëmijët e tyre nuk dëshironin të shkonin në shkollë.

Derisa një familje e riadhesuar theksonte që ishte regjistruar në shkollë pa ndihmë apo probleme, familjet tjera kishin marrë ndihmë në atë regjistrim nga Ministria e Punëve të Brendshme, ZKKK-ja, MASHT-i, në kuptimin e njohjes së dokumenteve shkollë si dhe bashkëpunimit me shkollën. URA 2 ka provuar të ndihmonte familjen romë të regjistronte fëmijët e tyre; megjithatë, fëmijët nuk dëshironin të shkonin në shkollë.

63 Rregullorja Nr. 10/2012, neni 6.

Fëmijët e një familjeje të riatdhesuar ndoqën një program gjuhe për të mësuar gjuhën shqipe në Shkollën Selman Riza një herë në javë. Një familje tjetër e riatdhesuar nuk ka ndjekur ndonjë program gjuhe, përkundër përkrahjes gjuhësore të ofruar nga URA 2.

Figura 13: Pjeswnarrja e fëmijëve të familje të riatdhesuara në programet gjuhësore



3.5. Shëndetësia

Edhe pse tri familje të riatdhesuara raportnin probleme të rënda shëndetësore në familje, nuk kanë marrë kurrfarë ndihme nga institucionet. Prapë, katër persona të riatdhesuar kishin theksuar nevoja të veçanta në familje, por, vetëm njëri kishte marrë ndihmë nga institucionet e Kosovës. Vetëm pesë persona të riatdhesuar kanë marrë ndihmë sociale. Një person i riatdhesuar nuk ka gëzuar ndihmë sociale, përkundër problemeve shëndetësore dhe një anëtar i familjes me aftësi të kufizuara. Ndhimja sociale është dhënë në këto pesë raste për shkak të fëmijëve nën 5 vjeç, si dhe në dy raste për shkak të paaftësisë për punë. Ka nivele të larta të pakënaqësisë me ndihmën mjekësore në dispozicion për personat e riatdhesuar (shih Figurën 10). Ka gjasë që kjo të ndodhë për shkak të numrit të vogël të personave të riatdhesuar që kanë pasur qasje në ndihmë mjekësore. Gjashtë familje të riatdhesuara kanë komentuar që kujdesi dhe ndihma shëndetësore duhen zgjeruar.


3.6. Regjistrimi

Përveç në dy raste, të gjithë anëtarët e familjeve të riatdhesuara, e që janë anketuar, janë regjistruar. Në një familje rome, katër fëmijë nuk kanë arritur të regjistrohen në mungesë të certifikatave të lindjes. Në një rast tjetër, gruaja e personit të riatdhesuar nuk ka arritur të regjistrohet për shkak të mungesës së certifikatës së lindjes dhe asaj të shtetësisë. Anketa ka gjetur vetëm një person të riatdhesuar i cili ka gëzuar ndihmë në procesin e regjistrimit (nga ZKKK).

3.7. Punësimi

Vetëm një person i riatdhesuar që është anketuar, nga komuniteti ashkali, ishte i punësuar (vetë-punësim – shtet-pula në treg) derisa të tjerët ishin të papunë. Shumica e pjesëmarrësve në anketë theksonin që do të donin të shihnin projekte të krijimit të të ardhurave dhe trajnime profesionale. Përkundër dispozitave në strategjinë dhe rregulloren përkatëse, Komuna nuk ka organizuar ndonjë trajnim specifik për të ndihmuar personat e riatdhesuar në kërkim të punësimit.⁶⁴ Megjithatë, sipas ZKKK-së, janë miratuar një numër relativisht i lartë i projekteve të krijimit të të ardhurave (deri në €2,000) mes viteve 2010 dhe 2012, si dhe vetëm katër janë refuzuar.⁶⁵

Figura 14: Gjendja e punësimit



64 Intervistë: Hysen Sllamniku (Zyrtar i ZKKK-së për kthim, si dhe anëtar i Komitetit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë/Kosovo Polje).

65 Intervistë: Halil Qerimi (Zyrtar i ZKKK-së për edukim), Muharrem Berisha (Zyrtar i ZKKK-së për zhvillim), si dhe Hysen Sllamniku (Zyrtar i ZKKK-së për kthim, si dhe anëtar i Komitetit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë/Kosovo Polje).

4. Konkludime

Gjysma e pjesëtarëve të riatdhesuar të intervistuar të komunitetit rom dhe ashkali nuk kanë mundur të kthehen në vendin e tyre të prejardhjes, ose më vonë janë vendosur diku tjetër pas një kohe të shkurtër. Megjithatë, raporti përfundon pozitivisht që të kthyerit janë pritur në arritje të tyre dhe janë regjistruar nga institucionet. Shumë persona të riatdhesuar kanë gjetur zgjidhje të përkohshme përmes të afërmeve të tyre kur janë kthyer në Kosovë, ose jetojnë në banesa me qira, të cilat përkrahen financiarisht nga Qeveria. Më se gjysma e të intervistuarve kanë përfituar nga strehimi i përkohshëm deri në shtatë ditë, e edhe më gjatë në disa raste. Megjithatë, kishte një mungesë të qartë të njohurive për këtë skemë.

Duket të ketë nevojë për përmirësime në të gjitha fushat e ndihmës për persona të riatdhesuar, siç vërehet nga komentet e pjesëmarrësve në intervista. Ka pasur pakënaqësi të madhe me programet e ndihmës të ofruara për personat e riatdhesuar, sidomos në lidhje me ndihmën mjekësore. Personat e riatdhesuar raportojnë që kishte ndihmë të pamjaftueshme të ofruar nga programe të ndryshme, si dhe që ndihma kërkohej për periudha më të gjata. Megjithatë, një numër i madh i të intervistuarve kishin marrë ndihmën dimërore (dru zjarri) si dhe gati të gjithë kishin marrë pakot ushqimore dhe higjienike. Pasi që rreth 75 për qind e të intervistuarve kishin kërkuar ndihmë, duket të ketë nivel relativisht të lartë të njohurisë për programet e mundshme të ndihmës, si dhe procesin e aplikimit për to. Por, shumë raste kanë dështuar në marrjen e përgjigjeve, ose përgjigjet kanë marrë tepër shumë kohë, që është e papranueshme, pasi që kjo ndihmë prek të drejtat themelore.

Një sërë aktorësh, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, ZKKK-në dhe MASHT-in, i ofrojnë familjeve të riatdhesuara ndihmë në regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, pas kthimit të tyre, si dhe në raportet e tyre me shkollat. Gjuha është problem i veçantë për fëmijët e kthyer, por përkrahja ofrohet në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Megjithatë, mund të ketë rezistencë ndaj vijimit të shkollës nga ana e familjeve të këtyre komuniteteve.

ANKETA KA GJETUR PAKËNAQËSI TË MËDHA MES PERSONAVE TË RIATDHE SUAR, NË LIDHJE ME KUJDESIN DHE NDIHMËN MJEKËSORE, SIDOMOS PASI QË SHUMICA E Pjesëmarrësve nuk e kanë gëzuar atë. Kriteret e pranimit kufizojnë mundësitë për qasje në atë ndihmë, derisa Kosova përballet me resurse të përgjithshme të kufizuara në kujdesin shëndetësor.

Hulumtimi ka gjetur që mungesa e dokumentacionit mbetet pengesë për personat e riatdhesuar. Edhe pse shumica e njerëzve kanë arritur të regjistrohen pa problem, ZKKK-ja ka ofruar ndihmë vetëm në një rast.

Papunësia është qartësisht sfidë kritike për personat e riatdhesuar, sidomos për komunitetet romë dhe ashkali, pasi që të gjithë pjesëmarrësit qenë të papunë, përveç njërit. Ka pasur përpjekje të pamjaftueshme për të adresuar situatën përmes ofrimit të trajnimeve për personat e riatdhesuar, përkundër dispozitave të Strategjisë për Komunitete dhe Kthim, si dhe Rregullores Nr. 10/2012 për Menaxhimin e Programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrim të personave të riatdhesuar.

Është shënuar një mungesë e madhe e njohurive në anën e personave të riatdhesuar për ndihmën dhe të drejtat që ata i kanë, gjë që duhet adresuar. Për më tepër, ka mungesë e njohurive për ekzistencën e Komitetit Komunal për Riintegrim, përkundër rolit të tij kritik në ofrimin e ndihmës për personat e riatdhesuar.

5. Rekomandimet


Pakot aktuale të ndihmës duhet të rishikohen dhe revidohen për të vlerësuar nëse i përmbushin nevojat e personave të riatdhesuar nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Ato duhen vlerësuar edhe në kuptimin e përshtatshmërisë për gra dhe fëmijë.

Materialet aktuale informative që ofrohen për personat e kthyer gjithashtu duhen rishikuar. Duhet hartuar një broshurë shumëgjuhëshe, e lehtë për t'u përdorur, informuese, në gjuhë të thjeshtë, me informata për institucionet, të drejtat dhe procedurat administrative. Broshura duhet t'i vihet në dispozicion të kthyerve ose më herët ose plotë të kthehen në Kosovë.

Dispozitat ligjore në lidhje me të drejtat e personave të riatdhesuar duhen qartësuar në mënyrë të përgjithshme, ashtu që të hiqen paqartësitë dhe të sigurohet që personat e riatdhesuar të kuptojnë të drejtat e tyre. Ka nevojë të qartësohet, për shembull, se si duhet definuar "integrimi i plotë".

Komiteti Komunal për Riintegrim duhet të ofrojë më shumë përpjekje vetëdijesi-mi, ashtu që të sigurohet që personat e riatdhesuar, sidomos ata të komuniteteve jo-shumicë, të kenë njohuri për rolin e tyre në procesin e kthimit.

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje duhet të organizojë shkolim dhe aftësim profesional (SHAP) si prioritet për personat e riatdhesuar. Trajnimet e tilla do të ndihmonin në rritjen e mundësive të punësimit.



Mundësitë e projektit për gjenerimin e të ardhurave kërkojnë reklamim më të mirë, dhe në veçanti informatat për procesin dhe kriteret për aplikim duhet të jenë të qarta dhe të qasshme për personat nga komuniteti rom dhe ashkali.

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje duhet të sigurojë që kërkesat për ndihmë që vijnë nga të kthyerit trajtohen me kohë, si dhe marrin gjithherë përgjigje.

Pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali duhet të kërkojnë të angazhohen më afër komunës, për të siguruar se ndihma e tyre është e pranueshme dhe adekuate për nevojat e personave të riatdhesuar nga komunitetet e tyre.

6. Referencat

Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), 2008. Rekomandimet për kthim dhe riintegrim të azilkërkuesve të refuzuar: Mësimet e nxjerra nga kthimi në Kosovë (Recommendations for the Return and Reintegration of Rejected Asylum Seekers: Lessons Learned from Returns to Kosovo). [pdf] gjendet tek: <<http://www.refworld.org/pdfid/484022172.pdf>> [shikuar në maj të vitit 2013].

ECMI Kosovë, 2012. Studim bazë: Ofrimi i arsimit për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë-Kosovës/Kosovo Polje (Baseline Study: Delivery of Education to Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Fushë Kosovë/Kosovo Polje Municipality). [pdf] gjendet tek: <http://www.ecmikosovo.org/images/pdf/Baseline_Study_ENG_for_print.pdf> [qasur në maj 2013].

Migration News, 1999. Refugjatët kosovarë (Kosovar Refugees). [online] gjendet tek: <http://migration.ucdavis.edu/mn/more.php?id=1801_0_4_0> [qasur në maj 2013].

Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012. Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2011, Rezultatet përfundimtare. [pdf] Prishtina: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gjendet tek: <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/QA_Raporti_ENG.pdf> [qasur në maj 2013].

OSCE, 2009. Implementimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, nëntor 2009 (Implementation of the Strategy for Reintegration of Repatriated Persons in Kosovo's Municipalities, November 2009). [pdf] Prishtina: Misioni i OSBE-së në Kosovë. Gjendet në: <<http://www.osce.org/kosovo/40180>> [qasur në maj 2013].

OSCE, 2011. Implementimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Integritit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (Implementation of the Action Plan on the Strategy for the Integration of the Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo), maj 2011. [pdf] Prishtinë: Misioni i OSBE-së në Kosovë. Gjetet tek: <<http://www.osce.org/kosovo/77413>> [qasur në maj 2013].

UNHCR, 2012. Pasqyrë Statistikore: Të rehat në fund të shtatorit 2012 (Statistical Overview: Update at the end of September 2012). [pdf] Prishtina: Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së. Gjetet tek: <[http://www.internal-displacement.org/8025708F-004CE90B/\(httpDocuments\)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/\\$file/Statistical+overview+September+2012.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F-004CE90B/(httpDocuments)/D108F6188A98652EC1257A9200494DE2/$file/Statistical+overview+September+2012.pdf)> [qasur në maj 2013].

UNHCR, 2009. Udhëzimet për kualifikim për vlerësim të nevojave për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova (Eligibility Guidelines for Assessing the International Protection Needs of Individuals from Kosovo). [pdf] Prishtina: Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së. Gjetet tek: <http://www.refworld.org/pdfid/4af842462.pdf> [qasur në maj 2013].

Legjislacioni dhe politikat

Rregullorja Nr. 10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret për përfitim për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Neni 15 (1.1).

Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010.

Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës (2009–2015), dhjetor 2008.

Intervistat me zyrtarë komunalë

Intervistat janë mbajtur në Komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, me:

Halil Qerimi (Zyrtar i ZKKK-së për edukim)

Muharrem Berisha (Zyrtar i ZKKK-së për zhvillim)

Hysen Sllamniku (Zyrtar i ZKKK-së për kthim, si dhe anëtar i Komitetit Komunal për Riatdhesim në Fushë Kosovë/Kosovo Polje).

Shtojca 1 – Pyetësor

Pyetësi: (Emri) _____ **Kthyer nga:** (Vendi) _____

Ky pyetësor ndihmon të maten dallimet mes standardeve në legjislacion dhe realitetit aktual, në kuptimin e qasjes në strehim dhe shërbime publike për familjet e riatdhesuara.

1. Informata të përgjithshme

1.1 Etnia: _____

1.2 Data e riatdhesimit: _____

1.3 Anëtarët e familjes të riatdhesuar?

1.3.1 Nëna	Po/Jo
1.3.2 Babai	Po/Jo
1.3.3 Fëmijët	Po/Jo
1.3.4 Anëtarë të tjerë të familjes	Po/Jo
Mosha e familjarëve: _____	

1.4 Mënyra e riatdhesimit?

1.4.1 Vullnetar	Po/Jo
1.4.2 Me forcë	Po/Jo
1.5.1 A jeni larguar nga Kosova për herë të dytë?	Po/Jo
1.5.2 Nëse po, viti i kthimit të parë: _____	

2. Banimi

2.1 A jeni kthyer në vendin tuaj të prejardhjes? Po/Jo

2.2 Kur jeni kthyer, keni pasur në pronësi banesë apo shtëpi? Po/Jo

2.3 Nëse jo, jeni pa shtëpi për shkak se shtëpia ju është shkatërruar pas vitit 1999, është e uzurpuar, apo ndonjë arsye tjetër? Po/Jo

2.4 Ku jetoni sot?

2.4.1 Në pronën tuaj
2.4.2 Në shtëpi të një të afërmi
2.4.3 Në banesë me qira

2.5 Nëse jetoni me qira, a keni mjete financiare të paguani qiranë? Po/Jo

- 2.6 A e subvencionon shteti një pjesë të qirasë? Po/Jo
- 2.7 Nëse po, deri në sa për qind e subvencionon shteti? _____
- 2.8 Kur jeni kthyer, a ju kanë ofruar strehim të përkohshëm? Po/Jo
- 2.9 Nëse po, për sa gjatë? _____
- 2.10 Keni ditur që strehimi i tillë i përkohshëm mund të ofrohet? Po/Jo
- 2.11 Nëse jeni kualifikuar për strehim të përkohshëm, a ju kanë ofruar të jeni pjesë e ndonjë skeme banimi më vonë? Po/Jo
- 2.12 Nëse po, për sa gjatë? _____
- 2.13 Nëse po, a ju kanë ofruar zgjatje afati për pjesëmarrje në atë skemë banimi? Po/Jo

3. Procesi i riatdhesimit

- 3.1 A mendoni se keni marrë përkrahje të mjaftueshme nga shteti në procesin e riatdhesimit në kuptimin e
- 3.2 A jeni pritur nga dikush prej institucioneve në aeroport? Po/Jo
- 3.3 Nëse po, ju kanë ndihmuar me transport deri tek vendi ku keni shkuar? Po/Jo
- 3.4 A keni marrë pakot ushqimore dhe higjienike: Po/Jo
- 3.5 Nëse po, për sa gjatë? _____

3.6 Sa të kënaqur jeni me strehimin/banimin:

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.7 Sa të kënaqur jeni me pakot e ofruara ushqimore dhe higjienike:

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.8 A keni pranuar ndihmë mjekësore:

Po/Jo

3.9 Sa të kënaqur jeni me ofrimin e ndihmës mjekësore:

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.10 A keni pasur ndihmë tjetër (ad hoc) sipas nevojës? Nëse po, çfarë?

(Organizata tjera dhe çfarë ndihme?)

Po/Jo

3.10.1 Sa të kënaqur jeni me pakon e materialeve?

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.10.2 Sa të kënaqur jeni me pakon e ndihmës në mobilie?

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.10.3 Sa të kënaqur jeni me pakon e ndihmës dimërore (dru zjarri)?

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.10.4 Të tjera? Çka?:

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

3.11 A jeni regjistruar nga ndonjë institucion apo organizatë si person i riatdhesuar, përveç regjistrimit në aeroport? Po/Jo

3.12 Nëse po, a e dini nga kush? _____

3.13 A keni bërë kërkesë në institucionet e Kosovës (ndihmë në renovim apo ndërtim të shtëpisë, proces të krijimit të të hyrave, regjistrim civil)? Po/Jo

3.14 Nëse po, sa gjatë keni pritur përgjigjen e institucioneve

1 javë/1 muaj/2 muaj /3 muaj /6 muaj /tjetër /pa përgjigje

3.15 Tregojeni nivelin e kënaqshmërisë me këto institucione:

3.15.1 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

3.15.2 Komiteti Komunal për Riintegrim

Shumë të kënaqur/deri diku të kënaqur/deri diku të pakënaqur/të pakënaqur

4. Arsimi

4.1 A keni fëmijë të moshës së shkollës fillore? Po/Jo

4.2 A janë regjistruar në shkollë kur janë kthyer? Po/Jo

4.3 Nëse po, kur? _____

4.4 Nëse jo, pse? _____

4.5 A ju ka ofruar ndokush ndihmë në regjistrim? _____

4.6 Nëse po, kush dhe si? _____

4.7 Nëse jo, pse? _____

4.8 A kanë ndjekur fëmijët tuaj ndonjë program të përkrahjes gjuhësore? Po/Jo

5. Shëndeti

5.1 A ka dikush nga familja juaj ndonjë problem serioz shëndetësor: Po/Jo

5.2 Nëse po, keni marrë ndihmë nga institucionet? Po/Jo

5.3 A e keni dikë në familjen tuaj me nevoja të veçanta? Po/Jo

5.4 Nëse po, keni marrë ndihmë nga institucionet? Po/Jo

5.5 A keni marrë ndihmë sociale? Po/Jo

5.6 Nëse po, pse? _____

6. Regjistrimi

6.1 A jeni të regjistruar (regjistrimi civil)? (Gjithë anëtarët) Po/Jo

6.2 Nëse po, keni marrë përkrahje në regjistrim? Po/Jo

6.3 Nuk jeni regjistruar, pse? _____

7. Punësimi

7.1 A jeni të punësuar?

Po/Jo

7.2 Nëse po, çfarë, ku? Privat/sektori publik/vetë-punësuar/tjera...

8. Pyetje përfundimtare

8.1 Cilat fusha të ndihmës duhen përmirësuar dhe zgjeruar? _____

8.2 Çfarë lloj ndihme tjetër duhet ofruar nga institucionet e shtetit? _____

8.3 Çfarë fushash tjera duhen mbuluar? _____

